

## **I. KRYETAR I AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE**

### ***Z. Emiliano Gjika***

Emiliano Gjika është jurist me përvojë të gjerë dhe të larmishme në fushën e të drejtës private dhe administratës publike. Pozicionin e Kryetarit të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) e mban që prej tetorit të vitit 2022. Përpara kësaj detyre, Z.Gjika ka shërbyer si Drejtor Juridik pranë Postës Shqiptare SHA, duke ofruar këshillim ligjor për administratën e lartë dhe Këshillin Mbikëqyrës, si dhe duke siguruar përputhjen e prokurimeve me legjislacionin në fuqi. Ai ka shërbyer edhe si këshilltar ligjor i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në vitet 2019-2020.

Përvoja e tij profesionale përfshin një gamë të gjerë rolesh, duke filluar nga analist dhe ekspert ligjor për organizata vendase, të huaja dhe ato ndërkombëtare si dhe lektor i të Drejtës Evropiane dhe të Drejtës Ndërkombëtare Publike. Sa i takon punës në sektorin privat, Z.Gjika ka mbajtur pozicione të larta si Këshilltar Ligjor dhe Drejtor i Menaxhimit të Kontratave në kompani të ndryshme si “ARMO” SHA, “Albitumen” SHA, ku ai ka negociuar dhe hartuar kontrata, ka ofruar konsulencë ligjore dhe ka menaxhuar çështjet ligjore dhe kontraktuale të shoqërive tregtare.

Diplomuar si jurist në Universitetin e Tiranës dhe me një Master në Drejtësi nga Universiteti i Oksfordit, Z.Gjika zotëron njohuri të thelluara të të drejtës së detyrimeve, legjislacionit tregtar, atij doganor, të drejtës ndërkombëtare financiare dhe të acquis të BE në disa prej këtyre fushave.

## **II. DREJTOR I DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE NXITJES SË KONCESIONEVE**

### ***Z. Besard Buzi***

Besard Buzi është një avokat i përkushtuar me një përvojë të pasur në drejtimin e departamenteve ligjore dhe menaxhimin e projekteve komplekse. Nga viti 2018 deri në 2023, ai ka shërbyer si Kryetar i Drejtorisë së Metodologjisë dhe Ligjit në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave mbi Pasurinë në Tiranë. Gjatë kësaj periudhe, ai ka mbikëqyrur çështjet ligjore, ka draftuar dispozita të reja ligjore për aplikimin e taksës mbi pasurinë dhe ka siguruar zbatimin e kërkesave ligjore nga të gjitha bashkitë e Shqipërisë. Përvoja e tij përfshin menaxhimin e ankesave të tatimpaguesve, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve me projekte ndërkombëtare si Pro-tax, dhe udhëheqjen e një ekipi prej 6 anëtarësh.

Përpara këtij pozicioni, Z.Buzi ka shërbyer si Partner Menaxhues në firmën ligjore Buzi & Associates (Modus) nga viti 2015 deri në 2018. Në këtë rol, ai ka drejtuar një firmë ligjore të shërbimit të plotë me 5-8 avokatë, duke mbikëqyrur projekte të ndryshme në bashkëpunim me OJQ dhe autoritete publike.

Gjithashtu, ai ka punuar si Ekspert vendas për Këshillin e Evropës, ku ka kontribuar në forcimin e strukturave të qeverisjes vendore dhe zbatimin e ligjit për shërbimin civil në Shqipëri.

Gjatë karrierës së tij, ai ka ndihmuar në zbatimin e projekteve të rëndësishme për zhvillimin e qeverisjes vendore dhe ka bashkëpunuar ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore dhe departamentin e administratës publike.

Besardi ka një përgatitje të thelluar akademike, me një Master në të Drejtën Ndërkombëtare të Biznesit nga Universiteti Qendror Evropian dhe një Master në të Drejtën e Biznesit nga Universiteti Marin Barleti. Përveç kësaj, ai ka përvojë të gjerë në fushën e ligjit tregtar dhe publik, duke ofruar konsulencë ligjore për klientë të brendshëm dhe ndërkombëtarë dhe duke marrë pjesë në projekte strategjike në sektorin e energjisë dhe politikave mjedisore.

Që prej Janarit 2024 mban postin e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Nxitjes së Koncesioneve.

### **III. DREJTOR I DREJTORISË SË ORGANIZIMIT DHE VLERËSIMIT TË KONCESIONEVE**

#### ***Z. Redon Guma***

Redon Guma është një profesionist ligjor me një eksperiencë të gjerë, që kryen detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Organizimit dhe Vlerësimit të Koncesioneve, që prej Prillit të vitit 2023. Ai u diplomua pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin Jopublik "Luarasi" në vitin 2009 dhe zotëron një Master në Shkenca Administrative nga "Universiteti U.F.O" në vitin 2011. Z.Guma ka një interes të veçantë për kërkimin shkencor, duke marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe duke publikuar punimet e tij në disa revista.

Karriera e tij përfshin role të rëndësishme si Shefi i Sektorit të Çështjeve Ligjore në "Posta Shqiptare" SHA nga janar 2022-mars 2023, si dhe jurist pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" nga maji 2018- janar 2022. Z.Guma ka akryer gjithashtu detyrën e specialistit ligjor në Shërbimin e Provës, Tiranë dhe këshilltar ligjor për kompani private si Eco System Technology dhe GS Green Standard në Fier.

Përveç kësaj, ai ka përvojë si avokat në "Afortiori Legal & Consulting" dhe në Cirkun Kombëtar të Tiranës. Përvoja e gjerë profesionale e Z.Guma përfshin si sektorin publik ashtu edhe atë privat në Shqipëri, duke e bërë atë një profesionist ligjor të gjithanshëm.